

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit Ramiz Hoti nga fsh. Ribar i Madh, K. Lipjan, të cilin e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.596417 të dt.12.10.2017, për shkak të veprës penale Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, në shqyrtim gjyqësor publik, të mbajtur me dt.25.10.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Arbresha Shala dhe të akuzuarit me dt.25.10.2018 merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuares:

Ramiz Hoti, i lindur me dt. 15.12.1971, në fshatin Ribar i Madh, ku edhe jeton, nga i ati Islam dhe e ëma Hakie e gjinisë Kozhani, me nr. personal 1002039865, i martuar, babë i 5 fëmijëve, shqipëtar, shtetas i Rep. Kosovës, më parë i padënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse :

Me datën 25.05.2017, në shtëpinë e tij, në fshatin Ribar i Madh, K.Lipjan, me qëllim të përfitimit të shërbimit komunal ka keqpërdorur energjinë elektrike, në atë mënyrë që ka bërë lidhje direkt përmes një kabllë pa njëzorë, me ç'rast, energjia elektrike nuk është regjistruar fare përmes njëzorit pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar për energjinë elektrike,-

- me këtë ka kryer veprën penale Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së,

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, 321 par. 1 të KPRK -së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin e gjykon me:

D E N I M M E K U S H T

Me dënim me gjobë në shumë prej 200-€, dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 muaji, e të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afat prej 1 viti nuk kryen veper tjeter penale.

E dëmtuara KEDS-i distrikti në Ferizaj udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizoi në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor kësaj gjykate t'i paguaj shumën prej 20.-€ dhe shumën prej 30.-€ në Fondin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.5964/17 të dt.12.11.2017 e ka akuzuar të pandehurin Ramiz Hotin nga fsh, Ribar i Madh, K. Lipjan, për shkak të veprës penale Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësorë prokurorja e shtetit me rastin e pranimin të fajësise ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësise na ana e të pandehurit, pasi që pranimi i

fajësisë është bërë me vullnetin e plotë dhe në pajtim me dispozitat ligjore dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale e cila më vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se e ka paraqitur kërkesën në KEDS, për lidhje të re të njësorit elektrik dhe pasi është ardhur njësitë nga Ferizaj të njëjtit ia kanë vendosur njësinë një ditë më vonë dhe ka menduar se gjithqka është në rregull dhe për këtë kanë bërë një fletëparaqitje për lidhje të paautorizuar, ngase më parë kishte siguruar rrymen përkohësisht nga një kablo e zgjatur. Gjithashtu në fjalën përfundimtare ka shtuar se është mbajtës i familjes dhe asnjehere më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, dhe se dëmin ia ka paguar të dëmtuarës dhe ka kërkuar nga gjykata ti shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi që bindet se i akuzuari e ka kuptur natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, konform nenit 248 të KPPRK-së, gjykata e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73 të KPRK-së dhe si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i akuzuari për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, rrethanat familjare pra faktin se është mbajtes i familjes 7 antarshe, premtimin e dhën se ne te rdhmen nuk do te përsërisë vepra të tilla apo te ngjashme e veçanarishtë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallen përgjegjësisë penale dhe duke marr për bazë shkallen e rrezikshmerisë shoqerore te vepres penale, të njëjtit i shqiptoj dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozite ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej vepër tjetër penale.

Vendimi për shpenzime e procedurës penale dhe ate për paushallin gjyqësor u bazua në nenin 450 par.2 pika.6 të KPPK-së ndërsa shuma për pagesen në Fondin e Viktimave u bazua në nenin 39 të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit.

Vendim për kërkesen pasurore juridike u bazua në nenin 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN.

P.nr.741/17 me dt.25.10.2018

Sekretarjajuridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate